



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 340, datë 27.06.2023**

**PËR**

**TRANSFERIMIN E PËRHERSHËM TË KANCELARIT TË GJYKATËS  
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË KORÇË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, nenin 80, nenin 83 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 557, datë 29.12.2022 të KLGJ-së “Për krijimin, kompetencat dhe funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit”, të ndryshuar, vendimin e Këshillit të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Korçë nr.37 prot., datë 31.03.2023 “Për miratimin e strukturës, organigramës dhe përshkrimet e punës të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, vendimin e KLGJ nr. 303, datë 05.06.2023 “Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër”, si dhe në vendimin propozues nr.3260/2 prot., datë 07.06.2023, të Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër,

**VENDOSI:**

1. Z. {...}, ruan statusin e kancelarit në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin Shef Sektori, në Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 01.07.2023.
3. Njoftimin e këtij vendimi z. {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**